

CV-ja

Ferat Shala

Ka lindur në Vuçak të komunës së Drenasit, më 10 qershor të vitit 1964. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, ndërkaq të mesmen në Drenas. Fakultetin e Xehitarisë dhe Metalurgjisë, drejtimi i Gjeologjisë, e ka mbaruar në Mitrovicë, në vitin 1991. Në vitin 2006 ka magjistruar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës. Në mars të vitit 2013 ka doktoruar në Universitetin “Goce Delçev” të Shtipit (Maqedoni). Është doktor i shkencave gjeologjike. Ferat Shala është profesor asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë. Më parë ka dhënë mësim në Fakultetin e Gjeoshkencave në Mitrovicë dhe kolegjin universitar Tempulli. Ai po ashtu, ka qenë dhe vazhdon të jetë konsulent profesional i disa kompanive që merren me ndërtime dhe miniera. Për afër katër vjet (dhjetor 2008 – korrik 2012), ka drejtuar ndërmarrjen Trepça. Ka botuar me dhjetëra punime shkencore nëpër revista shkencore prestigjioze të vendit dhe botës, si: Shqipëri, Itali, Slloveni, Gjermani, Britani e Madhe, SHBA, Turqi, Austri etj. Ai, po ashtu me punime shkencore ka marrë pjesë nëpër konferenca, seminare dhe forume shkencore, në shumë vende të ndryshme të botës. Aktualisht është zëvendësministër në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë e Republikës së Kosovës.